



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 nëntor 2019
Nr. ref.: RK1462/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI78/19

Parashtrues

Miodrag Pavić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml.
nr. 270/2018 të 18 dhjetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Miodrag Pavić nga fshati Koretishtë, Komuna e Novobërdës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml. nr. 270/2018 të 18 dhjetorit 2018, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PA-II. nr. 6/2015 të 7 majit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 521/2017 të 12 dhjetorit 2017.
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 25 janar 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës to garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 maj 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 23 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 17 qershor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata gjithashtu kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren të dorëzojë një kopje të vërtetimit për pranimin e aktgjykimit të kontestuar (Pml. nr. 270/2018 të Gjykatës Supreme të 18 dhjetorit 2018) nga ana e parashtruesit të kërkesës.
9. Më 24 qershor 2019, Gjykata Themelore në Prizren dorëzoi në Gjykatë vërtetimin për pranimin e aktgjykimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës, me datën e dorëzimit 25 janar 2019.
10. Më 8 tetor 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi parashtron kërkesë për herë të dytë në Gjykatë.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e parë KI104/16

12. Më 9 nëntor 2012, Prokuroria Themelore në Prizren parashtoi propozim akuzë në Gjykatën Themelore në Prizren kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale të marrjes së ryshfetit.
13. Më 29 janar 2015, Gjykata Themelore mori Aktgjykimin [K. nr. 82-2013], me të cilin e liroi parashtruesin e kërkesës nga propozim akuza për shkak të mungesës së dëshmive.
14. Prokuroria parashtoi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta prishë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ta kthejë çështjen në rigjykim. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit, ka dorëzuar përgjigje ndaj ankesës së Prokurorisë.
15. Më 15 korrik 2015, Gjykata e Apelit mbajti seancën për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Bazuar në pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe shkresat e lëndës, rezulton se në pajtim me nenin 390 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK), parashtruesi i kërkesës nuk ishte informuar për seancën e Gjykatës së Apelit.
16. Gjatë seancës së 15 korrikut 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PAKR. nr. 222/2015], me të cilin aprovoi ankesën e Prokurorisë dhe ndryshoi Aktgjykimin [K. nr. 82-2013] të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit e shpalli parashtruesin fajtor dhe i shqiptoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej një viti.
17. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015], parashtruesi parashtoi ankesë në Gjykatën Supreme duke pretenduar, *inter alia*, se Gjykata e Apelit mbajti seancë në të cilën ai u shpall fajtor, pa e njoftuar parashtruesin në lidhje me seancën, dhe kështu nxori vendim në shkelje të KPPK-së.
18. Më 1 dhjetor 2015, Gjykata Supreme mori Aktgjykimin [PA-II. nr. 6/2015], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.
19. Parashtruesi i kërkesës brenda afatit ligjor parashtoi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015] dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015].
20. Më 16 maj 2016, Gjykata Supreme mori Aktgjykimin [PML-KZZ nr. 110/2016], me të cilin e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë.

21. Më 9 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke pretenduar se Gjykata e Apelit e ndryshoi vendimin e shkallës së parë pa e njoftuar atë. Parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të mbrojtur me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, pasi që parashtruesi i kërkesës, si i paditur, nuk ishte njoftuar për seancën e Gjykatës së Apelit dhe kështu atij iu mohua e drejta e tij për të paraqitur argumentet e tij. Kjo kërkesë është regjistruar me numër KI 104/16.
22. Më 29 maj 2017, Gjykata nxori aktgjykimin e saj, duke gjetur se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kishin shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata e shpalli të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML-KZZ nr. 110/2016] të 16 majit 2016, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015] të 1 dhjetorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 222/2015] të 15 korrikut 2015 dhe e ktheu rastin në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës.
23. Gjykata konkludoi që duke mos e ftuar parashtruesin e kërkesës të jetë i pranishëm në seancën e Gjykatës së Apelit në të cilën ishte vërtetuar fajti i tij, parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar mundësia që të mbrohej ndaj akuzave të ngritura kundër ndaj tij. Si pasojë, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë dhe, në pajtim me këtë, urdhëron Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit të rishikojnë vendimet në përputhje me rekomandimin e Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e tanishme KI78/19

24. Më 9 tetor 2017, duke vepruar në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI104/16, Gjykata Supreme me aktgjykimin PML. nr. 110/2016 përsëriti procedurën në lidhje me kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, aprovoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe prishi aktgjykimin [PA-II. nr. 6/2015] e Gjykatës Supreme të 1 dhjetorit 2015 dhe aktgjykimin [PAKR. nr. 222/2015] e Gjykatës së Apelit të 15 korrikut 2015 dhe ktheu rastin në Gjykatën e Apelit për rivendosje, duke urdhëruar Gjykatën e Apelit që në procedurën e përsëritur ta ftojë parashtruesin e kërkesës në seancë.
25. Më 12 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit përsëriti procedurën dhe mbajti seancën e kolegjit për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Paditësi dhe mbrojtësi i tij u thirrën në mënyrë të rregullt në seancën e trupit gjykues, në përputhje me rekomandimin e Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata e Apelit nxori aktgjykimin [PAKR. nr. 521/2017], me të cilin e aprovoi ankesën e Prokurorisë dhe prishi aktgjykimin [K. nr. 82-2013] e Gjykatës Themelore të 29 janarit 2015. Gjykata e Apelit e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi me një vit burg.
26. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 521/2017] duke pretenduar, *"shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së të drejtës penale dhe vendimit mbi sanksionin penal."*

27. Më 7 maj 2018, Gjykata Supreme nxori aktgjykimin [PA-II. nr. 1/2018], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.
28. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 521/2017] dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme [PA-II. nr. 6/2015].
29. Më 18 dhjetor 2018, Gjykata Supreme nxori aktgjykimin [PML nr. 270/2018], me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.
30. Në pjesën përkatëse të arsyetimit të aktgjykimit të Gjykatës Supreme theksohet se, *"I pabazuar është pretendimi që gjykata e shkallës së dytë ka marrë aktgjykimin e saj pa shqyrtim duke pasur parasysh që nga shkresat e lëndës, dmth. nga shikimi në procesverbal nga dëgjimi publik të Gjykatës së apelit të mbajtur më 12.12.2017, mund të përfundohet që në seancë ka marrë pjesë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij [...]. Gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë pa marrë parasysh propozimin ankimor duke miratuar bazën ankimore të ligjit penal edhe pse propozim i tillë nuk është dhënë në mënyrë eksplicite. [...] pretendimi i cili ka të bëjë me mosrespektimin e nenit 6.3 të KEDNJ-së, duke marrë parasysh të drejtat e të akuzuarit të respektuara në përputhje me standardet e parashikuara me nenin e përmendur, dhe që të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij i është mundësuar të jenë pjesë aktive e të gjithë procedurës gjyqësore, duke filluar nga veprimet hetimore e deri tek mjetet juridike. Në bazë të rrjedhës së seancë gjyqësore dhe procesverbalit, mund të konstatohet që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë pasur mundësi të barabarta në raport me Prokurorin e shtetit kur është fjala për shqyrtimin e provave të dëshmitarëve"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në procedurën e përsëritur në gjykatat e rregullta janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
32. Parashtruesi i kërkesës arsyeton se në procedurën e përsëritur aktgjykimi PAKR. nr. 521/2017 i Gjykatës së Apelit, *"siç është përshkruar në tërësi nga aktgjykimi paraprak i parë i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR. nr. 222/2015 i 15.07.2015, i cili nga ana e Gjykatës kushtetuese të Kosovës, me aktgjykimin e Rastit nr. KI104/16 të 04.08.2017, është shpallur i PAVLEFSHËM"*.
33. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se, *"gjykata e shkallës së dytë ka marrë aktgjykim në kundërshtim me nenin 403 par. 1 i LPP-së së RK-së, sepse për ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka qenë e obliguar të caktojë – mbajë shqyrtim gjyqësor dhe me këtë të lajmërojë palët në procedurë në mënyrë që në mënyrë të duhur të vërtetohen/vlerësohen provat materiale."*

34. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se, *“Në kuptim të dispozitave nga neni 382 par. 2 i LPP-së, prokurori i shtetit ka propozuar që me ankesën e miratuar të anulohet aktgjykimi lirues i gjykatës së shkallës së parë në procedurën e përsëritur, e gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në kundërshtim në lidhje me propozimin e lartpërmendur të prokurorit dhe aktgjykimin e anuluar e ka ndryshuar, derisa të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar.”*
35. Parashtruesi i kërkesës në fund pretendon se, në pajtim me nenin 384 par. 1 pika 1 dhe 12 të LPP-së *“aktgjykimet e anuluarat të gjykatës së shkallës së dytë dhe të Gjykatës Supreme, janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse nuk janë paraqitur – treguar arsyet për provat vendimtare dhe për provat vendimtare ekzistojnë kundërthënie të konsiderueshme.”*

Pranueshmëria e kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

38. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet, nenit 47 [Kërkesa Individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa Individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

39. Sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion; se ka saktësuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe se e ka parashtruar kërkesën brenda afatit kohor.
40. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (2) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës i cili përcakton:

„(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij “.

41. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, por nuk i arsyetojnë të njëjtat.
42. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në thelb janë i) që nuk është zbatuar aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI104/16; ii) që gjykata e shkallës së dytë ka qenë e obliguar të caktojë shqyrtimin gjyqësor dhe për këtë t'i njoftojë palët në procedurë; dhe iii) që gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën procedurale dhe materiale sepse *„nuk janë paraqitur – treguar arsyet për provat vendimtare dhe për provat vendimtare ekzistojnë kundërthënie të konsiderueshme “.*
- (i) Sa i përket pretendimeve se nuk është zbatuar aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KI104/16**
43. Në lidhje me pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se pretendimet ankimore për shkelje të të drejtave kanë të bëjnë me mënyrën në të cilën Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit zbatuan vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI104/16 të 4 gushtit 2017.
44. Duke vepruar sipas rekomandimit të Gjykatës, Gjykata Supreme përsëriti procedurën në lidhje me kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, aprovoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe anuloi aktgjykimin [PA-II. nr. 6/2015] e Gjykatës Supreme të 1 dhjetorit 2015 dhe aktgjykimin [PAKR. nr. 222/2015] e Gjykatës së Apelit të 15 korrikut 2015 dhe

ktheu çështjen në Gjykatën e Apelit për rivendosje, duke urdhëruar Gjykatën e Apelit që në procedurën e përsëritur ta ftojë parashtruesin e kërkesës në seancën e kolegjit (shih: Aktgjykimi PML nr. 110/2016 i 9 tetorit 2017).

45. Duke vepruar sipas rekomandimit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit përsëriti procedurën dhe mbajti seancën e trupit gjykues për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij u thirrën në mënyrë të rregullt në seancën e trupit gjykues, në pajtim me rekomandimin e Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata e Apelit nxori aktgjykimin, duke aprovuar ankesën e Prokurorisë dhe duke e ndryshuar aktgjykimin [K. nr. 82-2013] e Gjykatës Themelore të 29 janarit 2015. Gjykata e Apelit e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi me një vit burg (shih: Aktgjykimin PAKR. nr. 521/2017, të 12 dhjetorit 2017).
46. Gjykata vëren se Gjykata Supreme me aktgjykimin PML. nr. 110/2016 e 9 tetorit 2017 si dhe Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR. nr. 521/2017 e 12 dhjetorit 2017, korrigjoi shkeljet e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së, të cilat Gjykata i kishte konstatuar në vendimin e Gjykatës Supreme PML-KZZ. nr. 110/2016 të 16 majit 2016, kur shqyrtoi kërkesën e parashtruesit nr. KI104/16 të 4 gushtit 2017.
47. Gjykata konstaton se, sipas rekomandimit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit përsëri mbajti një shqyrtim më 12 dhjetor 2017, në të cilin u ftuan paraprakisht të gjitha palët në procedurë dhe morën pjesë personalisht parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij.
48. Prandaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit korrigjuan shkeljen procedurale të lartpërmendur të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, dhe me këtë respektoi aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI104/16, prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mosrespektim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme në bazë të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.
- (ii) Lidhur me pretendimet se gjykata e shkallës së dytë ishte e obliguar të caktojë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i njoftojë palët në procedurë**
49. Në lidhje me pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës se gjykata e shkallës së dytë ishte e obliguar ta caktojë seancën gjyqësore dhe t'i njoftojë palët në procedurë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme urdhëroi përsëritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit.
50. Më tej Gjykata vëren se më 12 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit përsëriti procedurën dhe mbajti seancën e kolegjit për të shqyrtuar ankesën e Prokurorisë. Parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij u thirrën në mënyrë të rregullt në seancën e kolegjit dhe ishin të pranishëm në pajtim me rekomandimin e Gjykatës Supreme.

51. Përveç kësaj, Gjykata Supreme me aktgjykimin (Pml. nr. 270/2018), refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në detaje iu përgjigj saktësisht këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, si dhe secilit prej pretendimeve të parashtruesit veç e veç: “ ... nga shikimi në procesverbal nga dëgjimi publik të Gjykatës së apelit të mbajtur më 12.12.2017, mund të përfundohet që në seancë ka marrë pjesë i akuzuari dhe mbrojtësi i tij [...]. Gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë pa marrë parasysh propozimin ankimor duke miratuar bazën ankimore të ligjit penal edhe pse një propozim i tillë nuk është dhënë në mënyrë eksplicite. [...] pretendimi i cili ka të bëjë me mosrespektimin e nenit 6.3 të KEDNJ-së është i paqëndrueshëm...”.
52. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit, në procedurën e përsëritur, nxori vendimin pa ftuar parashtruesin e kërkesës dhe mbrojtësin e tij janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe se ato duhet të deklarohen të papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
- (iii) **Sa i përket pretendimeve se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën procedurale dhe materiale sepse „nuk janë paraqitur – treguar arsyet për provat vendimtare dhe për provat vendimtare ekzistojnë kundërthënie të konsiderueshme “.**
53. Gjykata fillimisht vëren se, në lidhje me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, i njëjti nuk është arsyetuar fare nga parashtruesi i kërkesës dhe se parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon se në cilat fakte vendimtare ekzistojnë kundërthënie, por ai thjesht konstaton se e drejta procedurale dhe materiale janë aplikuar në mënyrë të gabuar.
54. Gjykata rikujton, se nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë nëse lloje të veçanta të provave janë të pranueshme, dhe as çfarë provash duhet të paraqiten ose të tregojë se çfarë prova janë të pranueshme dhe çfarë jo, ky është roli i gjykatave të rregullta. Çështja në të cilën Gjykata Kushtetuese duhet përgjigjur është nëse procedurat në tërësi, duke përfshirë mënyrën në të cilën ishin marrë provat, ishin të drejta.” (Shih edhe rastin *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35394/97, paragrafi 34-35, GJEDNJ, Aktgjykim i 12 majit 2000).
55. Duke shikuar procesin në tërësi, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme në vendimet e tyre kishin përshkruar në mënyrë të detajuar dhe të plotë përfundimet e tyre, duke dhënë arsye të shumta në përgjigjen ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55).
56. Gjykata rithekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se vetëm fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo të gjykatave të tjera të rregullta, sikundër edhe vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës apo instrumenteve ndërkombëtare, nuk janë të mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse

(shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, paragrafi 33).

57. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk dëshmon se procedurat në gjykatat e rregullta shkaktuan shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], dhe 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
58. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në tërësi, në bazë të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 tetor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Radomir Laban

Radomir Laban



Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi